



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KËSHILLI

Nr. 677/7 Prot.

Pogradec, më 20.07.2023

VENDIM


NR. 21, DATË 17.07.2023

PËR  
MIRATIMIN E DHËNIES NË PËRDORIM TË FONDIT  
PYJOR/KULLOSOR, PËR QËLLIM "PËR MBARËSHTIMIN E FAUNËS  
SË EGËR DHE GJAHUT"

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/c, nenit 27 pika 5 nenit 54 pika "e" të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqëverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin Nr.8480 datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administrates shtetërore dhe enteve publike", neni 25 i Ligjit Nr.57/2020, "Për pyjet", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.398 datë 13.05.2020 për disa ndryshime në Nr.433, datë 08.06.2016, "Për transferimin sipas listës së inventarit të pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht në administrimin e Ministrisë së Mjedisit në pronësi të ish komunave/bashkive", pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.559, datë 29.07.2022, "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", në zbatim të Urdhërit Nr.87 datë 09.02.2023 nga Kryetari i Bashkisë "Për hartimin e Raportit Tekniko-Ekonomik", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. Të miratojë, dhënie në përdorim të sipërfaqeve të fondit pyjor me sipërfaqe 1.7 ha, për qëllime "Për Mbarështimin e Faunës së Egër dhe Gjahut" për afat përdorimi 9 vjet.
2. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, në respektim të pikës 7 të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit Nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor/kullor publik", *Sipërfaqja e marrë në studim do të nënshtrohet* procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë Pogradec, të nënshkruajë kontratën e qerasë, pasi të hyje në fuqi Vendimi i Këshillit Bashkiak, si dhe konfirmimi i Prefektit të Qarkut Korçë.
4. Çdo subjekt, të kryejë aktivitetin në sipërfaqet e miratuara vetëm mbas nënshkrimit të kontratës dhe dorëzimit të sipërfaqes me procesverbal dorëzimi nga struktura e Shërbimit Pyjor.



5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Teritorit, Shërbimi Pyjor dhe Drejtoria Juridike, Sektori i evidentimit dhe inventarizimit të asetëve dhe monitorimit të kontratave për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
7. U shpall sot më datë \_\_.02.2023.

**KRYETARI I KËSHILLIT**

**Sotirag MANGËRI**

